



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2661/1 prot.

Tiranë, më 27.12.2024

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektvendimit “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 13013/5 prot., datë 20.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2661 prot., datë 24.12.2024, me anë të së cilës dërgoni për bashkërendim projektvendimin “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare” (në vijim, “projektvendimi”), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektvendimit të ridërguar dhe dokumentacionit shoqërues, Zyra e Komisionerit vlerëson marrjen në konsideratë të sugjerimit të dhënë nga ana jonë, me shkresën nr. 2570/1 prot., datë 13.12.2024, për paragrafin e shtuar në “Formularin e Vetëidentifikimit të individit, shtetasit shqiptar që pretendon se i përket një pakice kombëtare”.

Me reflektimin e propozimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit shprehet dakord me projektvendimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi